**“LIRIDONI RM” Sh.p.k.**




| Koordinatat e poligonit | | |
|---|---|---|
| Nr. | Y | X |
| 1 | 7452569.699 | 4721414.524 |
| 2 | 7452730.500 | 4721398.001 |
| 3 | 7452881.752 | 4721337.049 |
| 4 | 7453140.100 | 4721257.771 |
| 5 | 7453116.170 | 4721124.072 |
| 6 | 7452873.127 | 4721141.135 |
| 7 | 7452806.754 | 4721111.076 |
| 8 | 7452759.522 | 4721146.373 |
| 9 | 7452676.306 | 4721181.779 |

# RAPORT
## I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
## PËR EKSPLOATIMIN E RËRËS DHE ZHAVORRIT

**“LIRIDONI RM” Sh.p.k.**

Pejë

Nëntor-2025

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**

Në bazë të nenit 16 paragrafit 1 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.03L/214 dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, për Hartues të Raporteve të VNM, Ministri i MMPH lëshon:

Nr. i licencës: 46/19

# LICENCË

## Menderes HALABAKU, Inxhinier i Diplomuar i Gjeografisë

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-së

Data e vlefshmërisë:
12.08.2019— 12.08.2024
Prishtinë

Fatmir Matoshi
Ministër i MMPH-së

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

## FORMULAR PËR KËRKESA

| | Përshkrim i shkurtër i kërkesës | PO |
|---|---|---|
| Kërkesë për: | Kërkesë për vazhdimin e licencës për hedhjen e inerteve [illegible] | |
| VËREJTJE | | |

| | |
|---|---|
| Emri dhe mbiemri i palës , adresa | Menderes Halabaku<br>Bzhorau Viti |
| Numri i telefonit<br>E-mail | 044194474<br>menderesh.h@yahoo.com |
| Numri i mobilit | 044194474 |
| Nënshkrimi i palës | Menderes Halabaku |

Sekretari i Përhershëm, e-mail: zspm_maph@yahoo.com
Tel ++381 38 200 32 010, Fax ++381 38 517 800, Rruga Nazim Gafurri 31, Prishtinë

| | |
|---|---|
| Investitori : | **INVESTITORI:**<br>KOMPANIA “LIRIDONI RM ”Sh.p.k<br>Rexhë Muqaj<br>Pronar<br>____________________<br>V.V |
| Emërtimi i projektit | Raport<br>I Vlerërsimit të Ndikimit në Mjedis<br>Për fushën e shfrytëzimit për rërë dhe zhavorr |
| Lokacioni : | Vragoc-Pejë<br>**P-71611016-00166-1** |
| Hartuesit e Raportit të VNM-s | 1. Mendere Halabaku<br>____________________ |

Vërejtje: Në projektin e dorëzuar të VNM për kompaninë “LIRIDONI RM” , kompania në dokumentacionin përcjellës të kompanisë ka bashkangjitur edhe kopjen e planit të cilat nuk duhet të jenë pjesë e aplikacionit. Kompania ka aplikuar p;r pjhesën e ngastrës **P-71611016-00166-1 dhe për asnjë tjetër. Kompania kërkon falje për këtë gabim teknik.**

1. Hyrje

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit ne Mjedis ( VNM)

Kompania “LIRIDONI RM”Sh.p.k. nga Peja është një kompani vendore e regjistruar në Kosovë e specializuar për të ushtruar veprimtarinë në hulumtim, shfrytëzim dhe procesim të resurseve minerale. Kompania posedon përvojë në nxjerrjen dhe seperimin e rërës dhe zhavorrit i cili është i nevojshëm për industrinë e ndërtimit në Kosovë. Kjo është arsye që kompania ka vendosur të investoj për hapjen e fushave të reja të nxjerrjes dhe përpunimit të rërës dhe zhavorrit. Kjo kompani është e përkushtuar që kriter kryesorë të sajë ta ketë mrojtjen e mjedisit jetësor në ambientet ku nxjerret dhe përpunohen rërat dhe zhavorret duke u munduar që edhe prodhimi final të jet kualitativ dhe i cilësisë qfar e kërkojnë kritetret e ndërtimit në Kosovë.

Me këtë program të VNM-së do të përshkruhet metodologjia të cilën do ta implementojmë gjat kohës së hartimit të fizibilitetit për VB e rërës dhe zhavorrit në lindje të Pejës, zonë e cila është karakteristike për rezerva të bollshme të rërës në këtë lokalitet dhe e një rëndësie të veçant për zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Kompania “LIRIDONI RM”Sh.p.k. nga nga Peja këtë veprimtari e ka ushtruar në këtë lokacion e dhe më parë , kjo do të jetë një ndihmesë shtesë për pëgatitjen e këtijë programi në këtë ngastër të re. Ky program do të hartohet konform rregullores për hartimin e studimeve të kësaj natyre, i cili kërkon nga istitucioni kompetent (MMPHI) Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe e Infrastrukturës, pajisjen e kompanisë me Pëlqim Mjedisor.

## 2. **Baza ligjore për hartimin e raportit**

Raporti i VNM-s është filluar të kryhet me nxjerrjen Ligji për MbrojtjeneMjedisit(Nr.09 /2003). Tani i hartuar Ligji i ri për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025. Ne lidhje me vlerësimin e ndikimit ne mjedis – VNM është aprovuar Ligji për VNM (Nr.08/L-181) i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dheparaqitjen për miratim te VNM. Ligji për VNM (Nr. Nr.08/L-181) ka për qellim për te siguruar mundësimin e një vlerësimi te përgjithshëm me ndërthurje te ndikimeve mjedisore te projekteve apo veprimtarive qe do te realizohen me qellim qe te parandalojnë dhe te zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative ne mjedis ne kohen e duhur.

Ligjet me te rëndësishme te aplikuara për hartimin e raportit të VNM-së përprojektin për eksploatimin e rërës dhe zhavorrit janë si me poshtë:

Ligjet

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM Nr. 08/L-181
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. **08/L-025**
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102

Udhëzimet Administrative

- Udhëzimi administrativ Nr.04/2022 për Lejen Mjedisore dhe plotësim ndryshimi i këtijë udhëzimi 05/2025
- Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2021 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes
- Udhëzimi administrativ për administrimin e mbeturinave të rrezikshme (06/2008)

- Udhëzimi administrativ Nr. 20/2012 për export, import dhe transit të mbeturinave
- Udhëzimi administrativ kompetencat e zotëruesit dhe operatorit për trajtimin e mbeturinave (08/2 Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011 për Pengimin e aksidenteve të mëdha ku përfshihen substancat e rrezikshme
- Udhëzimi administrativ Nr. 20/2011((Nr.04/2018)) për metodologjinë e zvoglimit të rrezikut nga aksidentet kimike dhe masat per eliminimin e pasojave.
- Udhëzimi administrativ Nr. 07/2012 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës.

- Udhëzimi administrativ për menaxhimin e deponive të mbeturinave(15/2012)
- Udhëzimi administrativ.Nr. **02/2022** përkushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujrave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor.

Gjatë hartimit të raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, përpos vizitave që iu janë bërë lokalitetit disa herë, konsultimeve që janë bërë me pronarin dheekspertët që e udhëheqin minerare, gjithashtu janë shfrytëzuar edhe:

- Elaborati gjeologjik për vendburimin ,,Vragoc", në Pejë
- Projekti i xehtaris për eksploatimin e rërës dhe zhavorrit
- Çertifikata e biznesit
- Çertifikata mbi të drejtën e pronës së paluajtshme
- Kopja e planit

Krahas parashikimeve themelore nga regullativat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit të VNM-s për rastin konkret janë shfrytëzuar edhe regullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi, procesin teknologjik për eksploatimin, e rërës dhe zhavorrit me aktivitetet tjera

Duke u nis nga fakti se një pjesë e madhe e mardhënjeve specifike nga lëmiae mjedisit nuk është përfshirë në rregullativat ligjore të tanishme prandaj për nevoja të hartimit të këtij raporti të VNM-s është shfrytëzuar përvoja e mirë dhe rregullat relevante ndërkombëtare, si dhe direktivat përkatëse për mjedis si qëështëdirektiva e VNM-s (85/337/EEC), gjithashtu janë shfrytëzuar edhe raportet evlerësimit të ndikimit ne mjedis për eksploatimin e rërës dhe zhavorrit i te njëjtit masiv në Pejë.

## 3. PËRSHKRIMI I LOKACIONIT DHE MJEDISIT

### 3.1. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni ku kërkohet të hartohet programi i hulumtimiti përket zonës kadastrale të Pejës në vendin e quajtur “Vragoc” dhe shtrihet në pjesën jug-lindore të Pejës, i cili është pjesë përbërse e Rrafshit të Dukagjinit.
Ky lokacion ku kërkohet hartimi i programit të VNM shtrihet mes fshatrave Gllaviqicë në veri, Vragoc në përëndim dhe Leshan në Lindje.




| Koordinatat e poligonit | | |
|---|---|---|
| Nr. | Y | X |
| 1 | 7452569.699 | 4721414.524 |
| 2 | 7452730.500 | 4721398.001 |
| 3 | 7452881.752 | 4721337.049 |
| 4 | 7453140.100 | 4721257.771 |
| 5 | 7453116.170 | 4721124.072 |
| 6 | 7452873.127 | 4721141.135 |
| 7 | 7452806.754 | 4721111.076 |
| 8 | 7452759.522 | 4721146.373 |
| 9 | 7452676.306 | 4721181.779 |

Foto(2) Sipërfaqja e ku kërkohet Pëlqimi Mjedisor është pjesë e ngastrës me nr. **P-71611016-00166-1**

Karakteristike e përgjithshme e pozitës së Pejës është se; ajo shtrihet në skajin veri-prendimorë të luginës së plleshme të Dukagjinit, para grykës piktoreske, nën shpatët e Alpeve shqiptare (Albanian Alps).Peja shtrihet në luginën e Lumbardhit rrethuar me Alpet Shqiptare. Peja, se bashku me tërë Rrafshin e Dukagjinit, shtrihet ndërmjet gjerësisë veriore gjeografike 45-50 shkallë dhe 42-53 shkallë dhe gjatësisë gjeografike lindore 19 shkallë, 58’ 30’ gjer më 21 shkallë. Qyteti i Pejës është i vendosur në teracën neogjene

aluviale në lartësi mbidetare 505-520m. Ky qytet ngritet në fushën e rrafshit të Dukagjinit dhe rrenzë bjeshkve të larta.Peja në pikpamje gjeomerfologjike përbën një tërsi ekonomike dhe në vete ruan e kultivon traditë të një historie të lashtë. Peja lidhet me çarkullimin rrugor me Prishtinën, Mitrovicën, Gjakovën, Rozhajën e Plavën.

Qyteti është i rrethuar me Bjeshkët, që janë pjesë e masivit dinamika që përfshinë tërë Ballkanin prëndimorë. Këto bjeshkë formojnë një kurorë majesh të larta siç janë: maja e Kopranikut (2460m), Mali Zhlep (2352 m), Hajlën (2460 m) Mokra (1932m), malet e Lumbardhit gjegjësisht Guri i Verdhë (2522m), maja e Viellakut (2012m), Peklena, maja e Hasanit etj.

Koordinatat me të cilat kufizohet zona e kërkuar për hartimin e projektit të VNM

Sipërfaqja e ku kërkohet Pëlqimi Mjedisor është pjesë e ngastrës me nr

**P-71611016-00166-1**

| Koordinatat e poligonit | | |
|---|---|---|
| Nr. | Y | X |
| 1 | 7452569.699 | 4721414.524 |
| 2 | 7452730.500 | 4721398.001 |
| 3 | 7452881.752 | 4721337.049 |
| 4 | 7453140.100 | 4721257.771 |
| 5 | 7453116.170 | 4721124.072 |
| 6 | 7452873.127 | 4721141.135 |
| 7 | 7452806.754 | 4721111.076 |
| 8 | 7452759.522 | 4721146.373 |
| 9 | 7452676.306 | 4721181.779 |

Zona e kërkuar e vendburimit nga pikëpamja fiziko-gjeografike gjendet dhe i përket zonës së Dukagjinit e cila dallohet për një reliev të rrafshët , shtrihet në pjesën jugore të lumit Lumbardh i Pejës në një distancë mbi 150 m. Kurse skica e detajuar e cila paraqet edhe situacionin të terenit ipet në vijim.

# P-71611016-00166-1




| Koordinatat e poligonit | | |
|---|---|---|
| Nr. | Y | X |
| 1 | 7452569.699 | 4721414.524 |
| 2 | 7452730.500 | 4721398.001 |
| 3 | 7452881.752 | 4721337.049 |
| 4 | 7453140.100 | 4721257.771 |
| 5 | 7453116.170 | 4721124.072 |
| 6 | 7452873.127 | 4721141.135 |
| 7 | 7452806.754 | 4721111.076 |
| 8 | 7452759.522 | 4721146.373 |
| 9 | 7452676.306 | 4721181.779 |

Poligoni kufizues

Parcela kadastrale

Ne kete lokacion ne afërsi të drejt për drejt nuk ekzistojnë objekte të banimit, objektet e banimit më të afërta gjenden ne largësi mbi 250m. Ne bazë tërezervave të rërës dhe zhavorrit dhe bazuar ne pozitën gjeografike të lokacionit që gjendet larg vendbanimeve, ne këte lokalitet ekzistojnë edhe kompani tjera që bëjnë eksploatimin e rërës dhe zhavorrit, lokacioni gjendet i larguar në një rreze rreth 300m nga lokaliteti I banuar. Sipërfaqja e tokës (ngastrave ku investitori do të bëj eksploatimin rërës dhe zhavorrit) dhe për rreth tyre është e mbuluar me një shtresë të humusit (tokë aluviale) e lehtë për punë dhe pjellore dhe me vegjetacion të ndryshëm.

## 3.2. Popullata dhe Vendbanimet

| | |
|---|---|
| **Shteti** | Kosova |
| **Qarku** | Peja |
| **Kryetari i Bashkisë** | Gazmend Muhaxheri |
| **Partia** | LDK |
| **Sipërfaqja dhe popullsia** | |
| **Sipërfaqja** | 603 $km^2$ |
| **Popullsia** | 95,723 banorë |
| **Dendësia** | 158.8 banorë/$km^2$ |
| **Të dhëna të tjera** | |
| **Kodi Postal** | 30000 |
| **Prefiksi** | +381 39 434-121 |

Peja-Qendër regjionale e Dukagjinit verior, identike për nga numri i banorëve me pandanin e vet jugor Peja me 95.723 banorë para fillimit të luftës, ka po ashtu të përfaqësuar mirë grupin terciaro-kuartar të popullatës, me të cilin qëndron para Prizrenit dhe e dyta pas Prishtinës, ndër qendrat kosovare me (32,6%). Dendësia e popullsisë është e madhe me rreth 300 banorë në 1 (një) km-2. nataliteti është 34, kurse mortaliteti 7.Peja është

qendër e një regjioni të gjerë me (afro 1.500 km-2), kurse Peja me fshatrat e saja ka 603 km2. Mbrenda kufive administrativ të Komunës së Pejës ka 97 vendbanime të organizuara në 28 bashkësi territoriale.

3.3. Në pjesën veriore të vendburimit kalon rruga magjstrale Pejë-Klinë-Prishtinë. Kjo rrugë ndodhet në një distancë mbi 500 m nga vendburimi, dhe nuk paraqet ndonjë pengesë nga zhvillimet e punëve operacionale në kompani.

### 3.4. Kushtet klimatike

Në këtë zonë mbizotron një klimë e butë kontinentale, karakteristikë ne nkësajë klime është sepse dimrat janë të ashpër e me lagështi kurse vera e nxehtë dhe e thatë. Varirimi i temperaturave në këtë zonë (Dugagjin) është ditorë, mujorë dhe vjetorë, kurse lëkundjet e vogla të temperaturave vjetore janë karakteristikë e këtijë baseni. Temperaturat më të ulëta janë në muajt Dhjetor, Janar dhe shkurt, ndërsa ato më të larta janë në muajt Korrik dhe Gusht.

Në zonën e vendburimit mbizotëron një klimë e butë kontinentale kurse në pjesën jugpërëndimore është klimë malore e cila shpesh është e ndërthurur me mikroklimat e kushtëzuara nga alterimi i luginave lumore në malet e larta që është karakteristikë e këtijë rajoni e këto sëbashku ndikojnë në modifikime të ndryshme të klimës kontinentale.

Në klimën e kësaj zone rol të rëndësishëm luan edhe rrjeti hidrografik i cili imponon edhe një mikroklimë në vete lokale e cila bënë që dimri të jetë më i butë dhe vera më e frerskët. Temperaturat mesatare gjat dimrit luhaten nga -0.5 deri +0.5°C por në raste të rralla temperaturat kan kaluar edhe -22 °C , ndërsa gjatë verës varirojnë nga 21.5 deri 22.8 °C

### 3.5. Relievi

Qyteti i Pejës është i vendosur në teracën neogjene aluviale në lartësi mbidetare 505-520m. Ky qytet ngritet në fushën e rrafshit të Dukagjinit dhe rrenzë bjeshkve të larta.Peja në pikpamje gjeomerfologjike përbën një tërsi ekonomike dhe në vete ruan e kultivon traditë të një historie të lashtë. Peja lidhet me çarkullimin rrugor me Prishtinën, Mitrovicën, Gjakovën, Rozhajën e Plavën.

Me rrjedhë të shpejtë grykës shkëmbore të Rugovës, lumi "Lumbardhi" fillon të gjarpron fushës së Pejës, duke kaluar në mes të qytetit dhe duke e ndar në dy pjesë. Lumbardhi i cili gjatë rrjedhjës formon fusha pjellore, derdhet në lumin më të madh të qujtur ' " Drini i Bardhë" që buron nga bjeshkët e Zhlepit në fshatin Radac. Lumbardhi ka një sasi uji prej 300 m-3 në sekond. Por malët e Pejës janë të pasur edhe me liqenjë si: Liqeni i Niçinatit dhe Liqeni i Ridit. Vetitë klimatike të Dukagjinit, pra edhe të Pejës, karakterizohen me klimë të mesme kontinentale të modifikuara, me komponente të klimës mesdhetare.

### 3.6. Hidrogjeologjia

Kjo zonë në kuptimin hidrogjeologjik i takon ujëmbledhësit të lumit Lumbardh i Pejës i cili me prurjet e tijë me kohë ka bërë pasurimin e kësaj zone me rërë dhe zhavor së cilës i përket edhe ky vendburim. Pjesa veriore në raport me VB është e përbërë nga argjilat mellonite dhe mergelet , tokat rreth lumit Lumbardh janë aluviale kurse kemi edhe formacione të zhavorreve të cilët formojnë shtresa kolektore prej 2-6m.

Niveli i ujrave nëntokësorë është i një karakteristike të veçant dhe ndryshon nga vendburimet tjera të larguara rreth 500m nga kjo zonë, sepse në këtë VB niveli i ujrave është rreth 4-5m nga sipërfaqja e tokës pëprderisa në VB tjera niveli i ujrave nëntokësor është më afër sipërfaqes sëpku për 1-1,5m.

Arsyeja mundë të jetë përshkak se pjesa veriore në raport me VB siç u cek më lartë ka një përbërje të mergeleve dhe argjilave ku këta dy përbërës janë të njohura si materiale jo ujlëshuese. Erozioni ka bërë që këta përbërës të barten nga prurjet e lumit dhe të krijojnë shtresa jo ujëlëshuese dhe të ndikojnë në nivelin e ujrave nëntokësor.

### 3.7. Pedologjia

Peja, është njëri nga qytetet më të pasura të Kosovës. Nga 603 km 2, po thuaj gjysma e teritorit ësht zonë malore- Rugova, e pasur më pyje e kullosa dhe e përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë. Pjesa tjetër qyteti më rrethin është tokë e pjellore dhe e punueshme, e përshtatëshme për zhvillimin e bujqësisë, pemtarisë, vreshtarisë etj.

Kurse pjesët nga të cilat kemi një proces të alterimit të shkëmbinjve kemi toka që shumë pak shfrytëzohen tokë bujqësore, por ma tepër janë livadhore me vegjetacion shumë të dobët të shkurreve dhe gjysmë shkurreve Harta pedologjike e rajonit të ngushtë , ku gjendet Mihja Sipërfaqësore është tokë ngjyrë kafe të cekët , lagështinë e marrin nga ujërat atmosferik .Ph është bazike sidomos në vendburimin e zhavorreve ku nga analizat kimike shihet se Ph është 8 deri në neutrale sepse nuk kemi materie e shkëmbinjve acidikë në afërsi të MS

Përbërje ma të madhe të tokave kemi me ngjyrë kafe (ranore e shkrifët) e ma pak ato të smonicës.

Tokat me ngjyrë kafe janë biologjikisht mjaft aktive të cilat kryesisht përdoren si toka bujqësore dhe dytat kalojnë në smonica dhe vështirë përdorën për bujqësi . Duhet të ceket se pas shfrytëzimit këto toka do ti rikultivojmë dhe ti kthejmë në toka antropogjenë gjendje të mëparshme .

### 3.8. Ndërtimi gjeologjik i venburimit dhe rrethines se gjere

Zona ku do të shfrytëzohen rëra dhe zhavorri në afërsi të Pejës "Vragoc", është pjesë e basenit të Dukagjinit, që si zonë është e mbivendosur transgresivisht në Miocen mbi bazamentin e zonës strukturale faciale Mirditë-Gjakovës*. Kjo zonë ka filluar jetën e sajë të historisë gjeologjike në kohën tektogjenezës alpine, me zhvillim të vrullshëm në Mesozoik. Në kenozoik një pjesë e sajë pësoi veprimtari të dendur të tektonikës disjunktive (horst grabenore). Kjo veprimtari madhore tektonike bëri që teritori i kosovës, i cili bënte pjesë në pellgun e madh Mesdhetar, në fundë të kenozoikut të kthehet në kushtet e një pellgu det-liqen paratetisian, duke u ndarë her në pellgje të veçanta her të bashkuara brenda malor me një zhvillim më të qetë gjeologjik me subsidencë apo ulje të madhe që sollën një depozitim shum të madh të depozitimeve liqenore. Ky zhvillim paleogjeografik liqenor, liqenoro- lumor krijoi kushtet për mirërritje të bimësisë me bollëk të madh e që bëri të mundur formimin e pelgut qymyror të Dukagjinit dhe formacioneve mbulesore të tarracave lumore me përhapje kryesore në rajonin hulumtues**.

** GJEOLOGJA E KOSOVËS PROF. DR. ZENUN ELEZAJ, PROF. DR. ALAUDIN KODRA

STRATIGRAFIA

Në ndërimin gjeologjik të rajonit marrin pjesë depozitimet molasike liqenore të kenozoit, që shtrihen transgresivisht mbi bazamentin kryesisht Mesozoik dhe shum pak Paleozoik.

PALEOZOIKU

Formacionet paleozoike vendosen në pjesët veriore dhe përëndimore të pellgut të Dukagjinit në një distancë të konsiderueshme nga vendburimi i rërës dhe zhavorrit. Përbëhen nga shiste filitike, kuarcore, metamorfike, mermere si dhe shkëmbinjë efuziv dhe intruziv.

## . MESOZOIKU

Formacionet mesozoike si pjesë e bazamentit apo kornizës kufizuese të pellgut neogjenik të Dukagjinit përfaqësohen nga shkëmbinjtë karbonatik triasik, që përhapen në zonën jug-përëndimore të hulumtimit, nga ofiolitet Triasiko-Lisike dhe melanzhin përkatës që përhapet në zonën e volljakës dhe Pejës. Shkëmbinjtë karbonatik të kretakut përbëjnë buzën lindore të pellgut verior të Dukagjinit.

Masivet ujëmbajtëse si kolektorë për rreth pjesës verilindore të pellgut të Dukagjinit mundë të ketë qen shkaku i zhvillimit të hovshëm të florës në periudhën pontiane , që ka ndikuar në formimin shtresës qymyrore me trashësi të madhe.

## KENOZOIKU

Duke u bazuar në hartën gjeologjike të rajonit, depozitimet e kenozoikut mbulojnë pothuajse tërsisht këtë teritor , dhe këto depozitime vendosen në mënyrë transgresive mbi depozitimet e ashtuquajtura të bazamentit të cilat u cekën më lart.

## KUATERNARI (Q)

Formacionet e kuaternarit takohen në pjesët më të ulta të relievit, të depozitimeve liqenore Pontiane dhe sidomos në luginat lumore, Lumbardhi në zonën e Pejës si dhe lumenjëve e përrockave tjera që përshkojnë territorin.

## TEKTONIKA

Zona e vendburimit është pjesë përbërsë e ultësirës së Dukagjinit. Ultësira Dukagjinit përfaqëson në njësi neotektonike të zhytur dhe e kufizuar nga të gjitha anët, Ver, Jug dhe përëndim me morfostruktura me tendencë mbizotëruese në ngritje dhe të kufizuara me shkëputje neotektonike me një amplitudë deri 2000 m. Me kontrast më të vogël është shprehur kufiri lindor.

Ultësira e dukagjinit është një basen unik i akumulimeve qymyrmbajtëse të neogjenit dhe ka morfostrukturë të zhytur si forma tektonike dhe të vendosura mbi strukturat e lashta tektonike të komplikuara. Sipërfaqja e depresionit të Dukagjinit është rreth 2000 $km^2$ , por në qoftë se merret parasyshë edhe baseni Bellanicës i cili gjat Pliocenit të hershëm dhe mbarimit të Pliocenit të vonshëm ka qen lidhur me ultësirën e Dukagjinit, sipërfaqja e përgjithshme e Ultësirës së Dukagjinit do të ihste rreth 3000 $km^2$ . Ultësira e dukagjinit gjat zhvillimit të sajë në kohë ndahet në disa ultësira më të vogla të veçanta siç janë:

1. Ultësira e Pejës
2. Ultësira e Gjakovës
3. Ultësira e Prizrenit dhe
4. Ultësira e Bellanicës

Zona e vendburimit i takon nënultësirës së Pejës.

### 3.9. Bimësia dhe vegjetacioni

Pjesët e ngastrave ku do të eksploatohet rëra dhe zhavorri janë toka pjellore të pa punuara nga faktori njeri , manaferra e kaçuba, ne bazë të shqyrtimeve vizuale ne afërsi të zonës ku do të eksploatohet rëra dhe zhavorri kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore , manaferra , etj. Këto bimë u përshtaten kushteve të jetës së tyre në këto toka ranore. Lokacioni përbëhet nga tereni I rrafshët - fushor, me vegjetacion të ulët. Ngastrat ku do të eksploatohet rëra dhe zhavorri përmbajnë vlera ekonomike në kuptimin e përdorimit si tokë bujqësore, por edhe si zone me vlera kullosore.

Nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë terren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/territor potencial të futet nën mbrojtje.

Por kjo zonë për shkak të pozitës gjeografike dhe rezervave të rëra dhe zhavorrit është shëndrruar ne zonë industriale, për eksploatimin dhe përpunimin e rëra dhe zhavorrit ku është duke operuar shpk,,LIRIDONI RM" dhe kompani të tjera.

### 3.10. Bota shtazore – Fauna

Zona e ngushtë mund të quhet si zonë jo e përshtatshme për zhvillimin e specieve të ndryshme të faunës sepse është zona në aferësi të vendbanimeve.

Bazuar ne florën ekzistuese dhe kushtet klimatike si dhe ne bazë të dhënave nga vendasit në këtë zonë përpos kafshëve dhe shpezëve shtëpiake, jetojnë edhe gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, iriqi etj.

Prej brejtësve jetojnë- mijtë , prej zvarranikëve- gjarpri i zakonshëm , bolla ,breshkat e tokës zhapini i gjelbër , insektet krahëfortë , krahëlusporë, mizat etj, ndërsa prej shpezëve janë karakteristike zogjtë, çafkat , bilbilat , thëllënëza e fushës , sorrat , shqiponja , lakuriqi, etj.

### 3.11. Peisazhi

Rajoni i Dukagjinit, e veçanërisht qyteti i Pejës dhe bjeshkët që e rrethojnë atë, janë pikë kryesore referente për turistët botëror, që e vizitojnë Kosovën. Ky interesim vie në radhë të parë për shkak të bukurive magjepsese të Bjeshkëve të Nemuna, ku pjesa më e madhe e të cilave shtrihet në Komunën e Pejës. Në saje të kësaj vlere turistike Komuna e Pejës kohë më parë ishte futur në finale si Destinacion turistik botëror me 3 shtete tjera. Në garën ku ishin edhe Singapuri, Bhutani dhe Dubai, ku Organizata Botërore e Turizmit, e zgjodhi fitues Pejën me projektin majat e Ballkanit "Tourism Tomoroë Aëard" me shtegun 192 km të gjatë, i cili përmban sinjalizimin turistik dhe rekreacionet sportive malore. Në saje të

kësaj vlere turistike Komuna e Pejës kohë më parë ishte futur në finale si Destinacion turistik botëror me 3 shtete tjera. Në garën ku ishin edhe Singapuri, Bhutani dhe Dubai, ku Organizata Botërore e Turizmit, e zgjodhi fitues Pejën me projektin majat e Ballkanit "Tourism Tomoroë Aëard" me shtegun 192 km të gjatë, i cili përmban sinjalizimin turistik dhe rekreacionet sportive malore.

### 3.12. Dukshmëria

Shikuar nga pozita e lokacionit ku do të eksploatohet rëra dhe zhavorri dhe relievit, dukshmëria është mjaft e lartë në të gjitha anët e horizontit. Ne pjesën jug-perëndimore dhe ajo jug-lindore ka një dukshmëri ma te madhe për gjate rrjedhës së Erenikut. Vendet që shtrihen ne këtë lokalitet karakterizohen më mjegulla dhe më lagështi të madhe të ajrit gjatë stinës së dimrit.

### 3.13. Ajri

Vegjetacioni i mirë, prania e madhe e llojeve të ndryshme të faunës janë treguesit kryesor për pastërtinë e ajrit.

Kjo është zonë kryesisht bujqësore, në afërsi nuk ka ndonjë uzinë ose aktivitet tjetër prodhues që do të ndikonte në ndotjen e ajrit.

Mund të konkludojmë se pastërtia e ajrit në këtë regjion është në nivel të mire.

### 3.14. Uji

Kjo zonë në kuptimin hidrogjeologjik i takon ujëmbledhësit të lumit Lumbardh i Pejës i cili me prurjet e tijë me kohë ka bërë pasurimin e kësaj zone me rërë dhe zhavor së cilës i përket edhe ky vendburim. Pjesa veriore në raport me VB është e përbërë nga argjilat mellonite dhe mergelet , tokat rreth lumit Ereniku, janë aluviale kurse kemi edhe formacione të zhavorreve të cilët formojnë shtresa kolektore prej 2-6m.

Niveli i ujrave nëntokësorë është i një karakteristike të veçant dhe ndryshon nga vendburimet tjera të larguara rreth 500m nga kjo zonë, sepse në këtë VB niveli i ujrave është rreth 8-10m nga sipërfaqja e tokës peprderisa në VB tjera niveli i ujrave nëntokësor është më afër sipërfaqes sëpku për 1-1,5m. Arsyeja mundë të jetë përshkak se pjesa veriore në raport me VB siç u cek më lartë ka një përbërje të mergeleve dhe argjilave ku këta dy përbërës janë të njohura si materiale jo ujlëshuese. Erozioni ka bërë që këta përbërës të barten nga prurjet e lumit dhe të krijojnë shtresa jo ujëlëshuese dhe të ndikojnë në nivelin e ujrave nëntokësor.

4. **Përshkrimi i procesit të eksploatimit në mihjen sipërfaqësore**

Për të e eksploatuar rërën dhe zhavorrin duhet të kryhen këto procese teknologjike:

duhet ber largimin e shtresës së dheut (sterilit), ngarkim dhe transport .

Për realizimin e procesit teknologjik për eksploatimin e rërës dhe zhavorrit nevojiten këto pajime: Ekskavatorë, një bulduzher , një lopatë ngarkuese dhe kamion special për bartjen e rërës dhe zhavorrit gjer te seperacioni.

Punimet e eksploatimit të rërës dhe zhavorrit në këtë vendburim do të zhvillohen sipas projektit kryesor të Xehetarisë ku duhët përcaktuar të gjithë parametrat tekniko-teknologjik për shfrytëzim. Në bazë të përvojës gjatë punës në kushte të njëjta dhe duke marrë për bazë karakteristikat e rërës dhe zhavorrit në vendburim janë përcaktuar parametrat kryesor për hapje të karrierës:

- lartësia e shkallëve është 2m.
- gjerësia e sheshit të shkallës është 10-15m.
- pjerrtësia punuese e shkallës është 75 gradë.
- eksploatimi i rërës dhe zhavorrit do të kryhet përmes 2 shkallëve.
- sterili dhe materiali humusor nëpër rrugë të projektuara do të bartët dhe

deponohet ne deponin e caktuar enkas për te e pastaj do të deponohet në sipërfaqen e shfrytëzuar.

- karakteristikat hidrogjeologjike janë të cekura më lart.

- hapja e karrierës bëhet duke u nisur nga kuota fillestare e vendburimit nga lartësia ne nivelin e kuotës 520m dhe nga thellësia ne nivelin e 510m.

**Vlera investive në eksploatimin e rërës dhe zhavorrit**

| Lloji I makinës | sasia | çmimi euro |
|---|---|---|
| Eskavator kobelko | 2 | 60,000.00 |
| Lugë ngarkuese | 1 | 35,000.00 |
| Kamion katër axial | 2 | 50,000.00 |
| Total | | 145,000.00 |

## 5. Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme ne mjedis

### 5.1. Ndikimet në ajër

Në aktivitetin e mihjes sipërfaqësore, ndikim negativ në mjedis shprehet edhe në ambientin e ajrit.

Në zonën e shtrirjes së trupit minerar ajri është i pastër. Deri te ndotja vie për shkak të punëve dhe aktivitetit në mihjen sipërfaqësore , sidomos në fazën e, ngarkimit dhe transportit.

Ndotësit janë kryesisht pluhurat që barten me anë të erës , por duke iu falënderuar formës së relievit dhe konfiguracionit të terenit bartja e pluhurit me anë të erës nuk arrin deri te vendbanimet e banuara më të afërta, pasi se ato janë larg nga lokacioni ku do të eksploatohet rëra dhe zhavorri .

Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimit të gazrave nga automjetet e ngarkimit dhe transportit të cilat si lëndë djegëse përdorin derivatet e naftës.

Përbërja e rërës dhe zhavorrit në shfrytëzim nuk përmban materie të dëmshme.

### 5.2. Ndikimet në tokë

Si ndikim negativ në tokë paraqitet masa sterile e cila duhet të largohet nga sipërfaqet e punës.

Trashësia e sterilit sillet prej 30 cm gjerë 1 m, depozitimi i tij duhet të bëhet në konsultim me projektuesin në zonën e punishtes, në një anë ku nuk pengon proceset minerare.

Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.

Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasusin e sipërm (ndikimet në ajër), si dhe me ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese.

Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese gjatë furnizimit dhe punës së tyre.

### 5.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë shkaktohen nga derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat të cekura në pasuset e më sipërm të cilat me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe ndotjen e ujërave nëntokësore.

Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor.

Ndikimet tjera negative janë edhe derdhja e ujërave të zeza, mbeturinat e ndryshme, etj.

### 5.4. Ndikimi në Peizazh

Lokacioni ku është mihja sipërfaqësore, gjithnjë do të merr pamjen e një vendi industrial.

Gjatë fazës së shfrytëzimit normalisht, peizazhi do të pësojnë një degradim i cili me masat të cilat do të merren në mbarim të shfrytëzimit do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen të përafërt me gjendjen e mjedisit me rrethinën .

Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit si masë për kompensimin të shfrytëzimit të pasurive /resurseve natyrore.

### 5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në mihjen sipërfaqësore për eksploatimin e rërës dhe zhavorrit dhe ate ne sipërfaqet operacionale ne gjatësinë kohore të eksploatimit flora tërësisht do të shkatërrohet, e cila duhet të rikultivohet pas përfundimit të punëve minerare.

Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni I veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës.

### 5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Në kompleksin e punimeve minerare të zhavorreve nuk ka objekte banimi , nuk do të kemi ndonjë rast të zhvendosjes së popullatës dhe as që pritet në të ardhmen të ketë për shkak të punimeve minerare.

Zhvillimi i veprimtarisë eksploatuese në këtë lokalitet ka një rëndësi të veçanet për popullatën e këtij rejoni. Pronari i Kompanisë ,,LIRIDONI RM" për të zhvilluar veprimtarin e vet do të jetë i obliguar të punësoj një numër të madh të punëtorëve, kryesisht nga popullata vendase, nga kjo del se ne aspektin social eksploatimi I rërës dhe zhavorrit do të ketë ndikime pozitive.

Rërëa dhe zhavorri i këtij vendburimi nuk përmban materieje të rrezikshme për shëndetin e njerëzve.

## 5.7. Zhurma

Zhurma, si element në teknologjinë e eksploatimit të rërës dhe zhavorrit ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara, duke pasur parasysh largësinë e tyre ngalokacioni.

Zhurma vjen si rezultat i aktiviteteve minerare kryesisht nga makinat gjatë procesit të shpimit, minimit ngarkimit, transportit etj.

Me shfrytëzimin e pajisjeve prodhuese bashkohore në bazë të standardeve të zakonshme maksimumi i zhurmës në burim duhet të jetë 90 dB.

Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 50 dB, kurse gjatë natës nuk do të punohet, por edhe kur punohet nuk do të jetë më e madhe se 45 dB.

Ne vijim po e paraqesim ne formë tabelore nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca.

| Zhurma | Distanca(m) | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 10 | 50 | 100 | 500 |
| 90dB-niveli<br>Për paisje moderne | 59 | 45 | 39 | 25 |

## 5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që në aktivitetin e mihjes sipërfaqësore mekanizmi punues do të jen mirë të mirëmbajtura , dhe të monitoruara nga ekspertët e lamive përkatëse dhe një herit kur dihet se brenda veprimtarisë prodhuese nuk kemi të bëjmë me materie tërrezikshme për mjedisin, por thjeshtë me materialin që e marrim po nga ky mjedis.

Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo etapë të proceseve teknologjike në punishte si:

Gjatë përgatitjes së fushës minuese dhe minimit

- Gjatë shpimeve, punëve në kate pune
- Gjatë proceseve tjera teknologjike në eksploatim të lëndës së parë
- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes)

## 6. Marja e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve

### 6.1. Masat e marura për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative të mundshme në ajër të krijuara nga realizimi i proceseve teknologjike për eksploatimin e rërës dhe zhavorrit të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa:

- Në mihjen sipërfaqësore, gjatë punës me eskavator duhet pasur kujdesë që të mos ket rrjedhje të vajrave lybrifikues në sheshin e ngarkimit.
- Të gjitha sipërfaqet operacionale dhe rrugët ( pjesët e pa asfaltuara) ku do të bëhet transportimi i masës së nxjerrun duhet të mirmbahen.
- Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda punuese me qëllim që lirimi i gazrave nga mjetet e punës të jetë sa më kualitativ.
- Kamionët të cilët bëjnë transportin e fraksioneve duhet të mbulohen me mbulesa adekuate.
- Duhet rregullisht të jetë ne disponim cisterna me ujë rezervë.

### 6.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar dhe zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë nga realizimi i proceseve teknologjike për eksploatimin e rërës dhe zhavorrit duhet marrë këto masa mbrojtëse:

- Masa bimore e larguar duhet të deponohet në vende të caktuar për shfrytëzim të mëtutjeshëm si dhe mos të lejohet kalbja e tyre.

• Pjesën humusore dhe argjilore të materialit steril duhet deponuar në vende të posaçëm me qëllim të ruajtjes për rekultivim biologjik.

• Erozionin duhet ta pengojmë me anë të rikultivimit biologjik ku është e mundur.

• Varësisht nga fronti i punëve në vendburim, në kohën më të shkurtër që është e mundur duhet të filloi procesi i rikultivimit, me ç' rast e tërë sasia e sterilit e cila mbetet do të përdoret për mbushje dhe nivelizim të hapësirave të krijuara nga proceset e shfrytëzimit të rërës dhe zhavorrit.

• Të ndërpritet puna në kohra me të reshura atmosferike me qëllim të mos ngjeshjes në masë të madhe të tokës.

• Duhet të merën masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve dhe vajrave nga makinat dhe pajimet prodhuese.

• Vaji i makinave duhet të ndërrohet në vende të caktuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë dhe ate ne ofiçinën për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve ngarkuese dhe transportuese.

• Nëse detyrimisht duhet të bëhet ndërrimi i vajit në lokacionin e eksploatimit

të rërës dhe zhavorrit për shkak te avarive ne makinat ngarkuese dhe transportuese, atëherë duhet siguruar enët adekuate për mbajtjen e vajit dhe duhet siguruar një pjesë nga materiali jo lëshues i vajrave dhe të vendoset nën makinën që riparohet.

• Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në minierë duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara, për mbeturinat tjera të ngurta të sigurohen kontejner të posaçëm të cilët do të i zbrazin kompanitë që kanë veprimtarin e grumbullimit të tyre dhe të i dërgojnë ne deponin regjionale.

• Mbeturinat e lëngta që krijohen nga ndërrimi i vajrave të pajimeve duhet të deponohen në enë të posaçme të cilat mbeturina do të i shiten kompanive të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.

### 6.3. Masat e marura për mbrojtjen e ujit

Mbrojtja e mihjes sipërfaqësore nga ndotësit e ngurtë të cilët mund të ndodhin gjatë bartjes me ujë nga të reshurat atmosferike ose ujrane nëntokësore të cilat janë të bollshme, duhet të bëhet me krijimin e kanalit rreth e përqark sipërfaqes së mihjes sipërfaqësore. Ky kanal nevojitet për mbrojtjen e mihjes sipërfaqësore nga vërshimet gjatë të reshurave atmosferike, dhe mbrojtjen e ujërave nga ndotësit mekanik dhe ndotësit me vajra e derivate, prandaj për pastrimin e ujërave të cilët rrjedhin nga hapësirat e mihjes sipërfaqësore gjatë të reshurave atmosferike duhet të rregullohen puset sedimentuese (tipi kaskadë) për sedimentimin e materieve të ngurta dhe seperatori për pastrimin e ujit të ndotur me vajra e derivate të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operacionale të mihjes sipërfaqësore, nga pajimet e punës, e pasandaj ujërat e pastra të lëshohen në recipient. Duhet rregullisht të pastrohen puset sedimentuese dhe seperatori. Në mihjen sipërfaqësore gjithmonë duhet të ketë në disponim absorbues të vajrave dhe derivateve. Ujërat e zeza duhet së pari te trajtohen në gropën septike e cila duhet të ndërtohet në varshmëri me numrin e punëtorëve e pastaj të lirohen ne recipient të pastërta. Gropa septike duhet të pastrohet nga pronari apo kompanitë e licencuara. Ne vijim po e paraqesim shemën teknologjike të trajtimit të ujërave të ndotura.

Skema teknologjike për trajtimin e ujërve




---

## 6.4. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtje nga zhurma. Për analizat dhe vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me ligjet dhe nivelet e lejuara për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.

Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merën të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e të lejuarës sipas rregullave në fuqi.

Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

## 6.5. Masat e marura për mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore

Masat për mbrojtjen e botës bimorë kryesisht lidhen ngushtë me ruajtjen e tokave në pjesët e ngastrave shfrytëzuese nga erozioni dhe masave mbi mbrojtjen e ajrit.

Kompania duhet të ketë kujdes që të mos deponoj pa kontroll mbeturina në vende të ndryshme por ato duhen të deponohen në vende me destinacion të caktuar.

Në raste të lajmërimit të zjarrit menjëherë të merën masa për neutralizimin e tij.

Pajisjet kundër zjarrit duhen të ruhen në mënyrë të veçantë.

Për mbrojtjen e botës shtazore kompania duhet të tregoj kujdes duke kufizuar lëvizjet e të punësuarve jashtë zonës eksploatuese dhe të kenë kujdes në nivelin e zhurmës, kualitetin e ajrit etj.

### 6.6. Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Për të evituar rreziqet aksidenciale gjatë eksploatimit të rërës dhe zhavorrit duhet ndërmarr këto masa:

- Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike.
- Duhet të kenë ne disponim kemikate neutralizuese për karburante të naftës dhe vajra.
- Duhet të bëhet plani i mbrojtjeve nga zjarri.
- Duhet e tërë fusha eksploatuese të thuret me tel gjembor.
- Të merën të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

## 7. Aktivitetet në raport me publikun

Shpk,,LIRIDONI RM" nga komuniteti ka respekt, për arsye të zbutjes së papunësisë në këte lokalitet të varfër , duke pasur parasysh llojin e projektit, kapacitetin e prodhimtarisë dhe potencialit të ndikimeve në mjedis, nuk ka pasur dhe nuk planifikon që të ketë ndonjë debat të ngushtë publik apo edhe të veçantë me publikun.

## 8. Programi i monitorimit

